

Mrika LIMANI

UÇK-ja në kontekst të luftërave guerile të shekullit XX

Shekulli XX kishte për temë kryesore luftën, gjatë së cilit shekull ndodhën dy luftëra botërore, ku në secilën prej tyre vdiqën miliona njerëz. Pas Luftës së Dytë Botërore, historia botërore u karakterizua me ulje të nivelit të konfliktit të hapur, por ngritje të theksuar të ngjarjeve të luftërave të vogla, ose luftërave guerile. Natyra e ndryshuar e luftimit gjatë shekullit XX ishte sfiduese, ngaqë, secila luftë apo konflikt që ngjante po sillte numër më të madh të vdekurish sesa luftërat që ngjanin në shekujt paraprak dhe në të njëjtën kohë po paraqitej si formë pasive e konflikti, e cila me vështirësi mundej nga ushtritë që mbronin pushtetet dhe hierarkitë e vendosura politike. Në një formë, shekulli XX paraqet periudhën kur u definua lufta revolucionare si armë e grupeve të shtypura politikisht, të grupeve të marginalizuara në bazë të përkatësisë etnike, si luftë kundër pushtetit të konsoliduar imperial dhe përfundimisht luftë kundër kolonializmit ushtarak, politik dhe kulturor.

Sipas të dhënave historike, nga vitit 1919 deri në 1997, shpërthyen rreth 500 luftëra guerile përreth botës.¹Me valët e ndryshme revolucionare që ngjanë përgjatë fillimit të shekullit XX, në kontekst të zhvillimit të ideologjisë politike, marksizmi konsiderohet si shtylla

¹Carles Boix, 'Civil Wars and Guerrilla Warfare in the Contemporary World: Toward a Joint Theory of Motivations and Opportunities', in S. N. Kalyvas, I. Shapiro, and T. Masoud, eds., *Order, Conflict, and Violence*, (Cambridge, 2008), p. 197, <http://ebooks.cambridge.org/ref/id/CBO9780511755903A020>, accessed 5 November 2017.

mbajtëse e ideve revolucionare mbi të cilat u ndërtuan grupet revolucionare guerile. Megjithëse jo të gjitha lëvizjet guerile në Evropë, Azi dhe Amerikë përvetësuan ideologjinë marksiste si kauzë të tyre, ata përfaqësuan në thelb koncepte të rrëzimit të pushtuesit nga një pozitë e disavantazhuar që ngjanin me luftën binare ndërmjet proletariatit dhe borgjezisë.

Në këtë kontekst, zhvillimi i luftërave guerile në kuptim të revolucionares gjatë shekullit XX u paraqit si përgjigje ndaj përparimit të hovshëm ushtarak të shteteve të Perëndimit, kështu duke rrjedhur si alternativë e vetme e arritjes së çlirimit ndaj forcave që ishin ushtarakisht dukshëm më superiore sesa e atyre që e konsideronin vetën të pushtuar. Meqenëse luftimi i këtyre forcave ishte i pamundur në formë konvencionale, atëherë grupet të gatshme për kryengritje, përvetësuan taktika jo-konvencionale të sulmit duke i zënë kundërshtarët në pritë dhe duke u tërhequr në shpejtësi për t'i paraprirë kundër-sulmit. Këto metoda janë tipari kryesor i ushtarëve guerilë, dhe u përvetësuan që nga IRA (Ushtrisë Republikane Irlandeze) në vitet e '20, nga Mao Ce Duni në luftën civile të Kinës përgjatë viteve të '20 deri në 1949, lufta e Vietminh (Lidhja për Pavarësi të Vietnamit) kundër kolonialistëve francezë (1953)², nga kubanezët që luftuan Batistan (1953-1959), nga kenjanët që luftuan pushtimin kundër britanikëve (1952-1964), nga fronti nacionalçlirimtar i Farabundo Martit, në Salvador, kundër ushtrisë së Salvadorit që nga vitit 1979, e madje edhe UÇK kundër policisë serbe dhe ushtrisë jugosllave.

Në studimin e luftërave guerile është e një rëndësie të posaçme të definohen identitetet shoqërore që tregojnë kontekstet shoqërore dhe

²Max Boot, *Invisible Armies: An Epic History of Guerrilla Warfare from Ancient Times to the Present*, 1st edn, (2013), p. 174.

politike në rrjedhat historike, në mënyrë që të kuptohet më mirë se përse janë adoptuar qëndrime antikolonialiste dhe më tutje për të kuptuar se përse identiteti kombëtar është brumosur më fuqishëm brenda këtyre kornizave identifikuese. Në këtë aspekt, definicioni i Eric Hobsbawm për “banditët socialë” është shumë relevant ngaqë i qaset tematikës së “banditërisë”, siç është definicioni historik i kaçakëve shqiptarë, si revoltë e shtresave të sunduara kundër shtresave okupuese.³Në këtë kontekst, mund të jetë edhe e vetëkuptueshme që nisja e kryengritjeve dhe luftërave guerilë, shpeshherë ngjet brenda territoreve më rurale, ku qasja për të tjerët është më e vështirë.⁴ Në vazhdë të kësaj, duhet qartësuar që revolucionet që nga vetë natyra e tyre janë lëvizje ilegale që synojnë të rrëzojnë regjime politike.⁵

Kjo formë e luftës u bë e shpeshtë posaçërisht pas vitit 1945 për disa arsye. Shumë prej këtyre konflikteve përfshinin grupe nga Azia dhe Afrika të cilët mundoheshin të çliroheshin nga regjimet koloniale të shteteve evropiane. Me burime të pakta ushtarake, kryengritësit përdorën taktika guerile si mënyrë për t'i arritur qëllimet e tyre. Përdorimi i këtyre taktikave u aplikua edhe si pasojë e terrenit gjeografik në të cilin u zhvilluan këto konflikte, si xhungla e Vietnamit që ishte vështirë e depërtueshme për trupat që nuk e njihnin terrenin vendor, lufta e shkurreve në Zimbabvenë e sotme ose malet në Afganistan.Në këto konflikte, luftëtarët guerilë në shumicën e kohës

³Oskar Gustafson, *Social Banditry, Myth and Historical Reality: Conceptualising Contemporary Albanian Organised Crime against the Hajduks* (Lund University, 2017), p. 1.

⁴Robert Taber, *War of the Flea: The Classic Study of Guerrilla Warfare*, (2002), p. 28.

⁵Ronald Grigor Suny, *Red Flag Unfurled: History, Historians, and the Russian Revolution* (London; New York, 2017), p. 223.

kishin përkrahjen e popullatës vendase dhe njohuri të mirë të terrenit ku vepronin.

Me fillimin e Luftës së Ftohtë pas vitit 1945, në një situatë ku të gjitha konfliktet shikoheshin përmes kontekstit të luftës së komunizmit kundër kapitalizmit, qeveritë që nuk kishin mbështetje nga populli, shpeshherë mbështeteshin nga superfuqitë tjera, gjë që nuk i linte mundësi tjetër popullatës vendase përpos të luftonte në formë të luftës jo-konvencionale. Meqë rreziku i konfliktit të drejtpërdrejtë ndërmjet SHBA-së dhe BRSS-së ishte shumë i madh, atëherë këto dyja shpeshherë mbështetnin kryengritës vendas në mënyrë që të mos luftojnë vetvetiu.

Sovjetikët dhe më pas kinezët ishin posaçërisht të interesuar të mbështetnin financiarisht dhe me municione lëvizjet popullore çlirimtare që qëndronin mbi platforma marksiste.⁶

Pas Luftës së Ftohtë, lufta guerile mori formë të organizimit më të madh qendror, si dhe përparimi teknologjik ia dha mundësinë luftëtarëve guerilë që të jenë më të rrezikshëm gjatë luftës. Në këtë kontekst është e rëndësishme të përmendet edhe mbulimi mediatik ndërkombëtar i kauzës për të cilën luftojnë guerilët, gjë që ia jep atë mënyrën e arritjes së mbështetjes për të cilën ata kanë nevojë, dhe në këtë formë e lehtëson luftën propagandistike dhe e rrit numrin potencial të rekrutëve, një fenomen që është vënë re shumë mirë në rastin e UÇK-së.

1. Konteksti ideologjik i zhvillimit të luftës së Kosovës

⁶Max Boot, *Invisible Armies: An Epic History of Guerrilla Warfare from Ancient Times to the Present*, 163.

Shikuar në kontekst historik, lufta e Kosovës kundër policisë serbe dhe më vonë ushtrisë së Jugosllavisë, mund të conceptohet si konflikt kolonial, ku grupi revolucionar që nisi luftë guerile po luftonte kundër një force pushtuese që ushtronte politika koloniale që ishin vendosur dhe ndjekur gjatë pjesës më të mirë të shekullit XX.

Zhvillimi i qëndrimeve ideologjike antikolonialiste ndodhi brenda diskursit materialist dhe si e tillë shërbeu si bazament për frymëzimin e disa gjeneratave për themelimin e lëvizjeve ilegale dhe përfundimisht për organizimin e revolucionit të armatosur. Si figurë më e spikatur historike që veproi përgjatë pjesës së dytë të shekullit XX në formulimin dhe mirëmbajtjen e një koncepti ideologjik antikolonialist dhe materialist, ishte Adem Demaçi, i cili që nga 1958 ishte konsideruar nga autoritetet jugosllave si figurë irredentiste. Megjithëse në shkrimet e tij të hershme ai nuk kishte formuluar qartë idenë për themelimin e një ushtrie kryengritëse, ai e kishte sjellë diskursin ideologjik brenda konceptit të një kryengritjeje gevariste (duke e vendosur kështu Kosovën në kontekst të Botës së Tretë), dhe në këtë formë kishte bërë thirrje për mbajtje të qëndrimit jashtë blloqeve protagoniste të Luftës së Ftohtë duke e vulosur qëndrimin antikolonialist të cilit do t'i qëndronte besnik përgjatë veprimtarisë së tij.⁷

Rryma e majtë ideologjike shërbeu edhe si platformë e ndërtimit të identitetit politik në filltet e grupeve ilegale me synim të organizimit të kryengritjes së armatosur. Ndër të tilla grupe ishin: Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi, Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe

⁷James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001* (Tiranë, 2013), 74.

Viseve të tjera Shqiptare, Lëvizja për Çlirimin Kombëtar të Kosovës, dhe grupime të tjera që varësisht nga rrethanat, ishin më pak ose më shumë aktive, dhe në fund u bashkuan në ideal të organizimit të një lufte të përgjithshme. Një kombinim i individëve nga këto organizata, eventualisht formuan Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e cila u shndërrua në Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK). Këto zhvillime përgjatë viteve të '80 të shekullit XX u vazhduan me themelimin e grupeve të tjera ilegale në vitet e '90, të cilat e shinin luftën si të pashmangshme për të arritur lirinë. E tillë ishte edhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), që u formua në mars të vitit 1993. LKÇK vendoste rëndësi të posaçme në përgatitjen e popullit për luftë në mënyrë ideologjike, politike dhe përfundimisht t'i përgatitnin ata për luftë në praktikë. Organ i LKÇK-së që promovonte propagandën politike ishte revista "Çlirimi", të cilën e botuan dhe e shpërndanë që nga 1993 deri më 1999.⁸

Një marrëdhënie e posaçme politike për përgatitjen ideologjike dhe ushtarake ishte edhe lidhja e shqiptarëve me shtetin amë, Shqipërinë, gjë që ndikoi qartazi edhe në përvetësimin e ideologjisë politike përgjatë viteve të '80. Ndikimi praktik i Shqipërisë, në anën tjetër, sipas disa burimeve, duket të ketë qenë prezent edhe gjatë viteve të '90, si në mbështetje ideologjike për zhvillimin e një lufte kundër Jugosllavisë, por edhe për ofrimin e trajnimit ushtarak për shqiptarët në Akademinë e Mbrojtjes së Tiranës. Më vonë, kjo mbështetje u përkthye në ndihmë të drejtpërdrejtë shtetërore në përgatitjen e kuadrove ushtarake për luftë. Në këtë pikë rol të rëndësishëm luajti

⁸Arnend R. Bekaj, 'The KLA and the Kosovo War: From Intra-State Conflict to Independent Country', *Berghof Transition Series / Resistanhce / Liberation Movements and Transition to Politics*, 8 (2010), 17.

RamizAlia, i cili mes të tjerave, e konsideronte themelimin e UÇK-së si një ekuivalente të Ushtrisë Republikane Irlandeze.⁹

Jashtë kornizave të zhvillimeve ideologjike, në praktikë tentativat për të organizuar veprimtari ushtarake u realizuan që nga fundvitet e '80, kur shqiptarët nisën rezistencë të armatosur në raste të prangosjes nga ana e policisë serbe. Në vitin 1989 u paraqit edhe grupi i parë i armatosur i njohur si “Çeta e Llapit”.¹⁰Ndërkaq, nga fundi i vitit 1990 ishte formuar organizata “Aradha Çlirimtare e Pejës”, e drejtuar nga Adrian Krasniqi-Rexha, e cila kishte filluar importimin e armëve të lehta në Kosovë.¹¹

Në fillim të viteve të '90, sulmet sporadike guerile u përhapën si sulme të organizuara të varganëve policore, të njësiteve individuale policore dhe zyrtarëve të policisë sekrete. Faza e hershme e zhvillimit të ofensivës i përkiste gjysmës së parë të viteve të '90, kur këto aksione po zhvilloheshin në Dukagjin nga Haradinajt, në Llap nga Zahir Pajaziti dhe në Drenicë nga Jasharajt. Por, pavarësisht që organizimet po bëheshin në nivele krahinore, synimi për luftë të armatosur nuk kishte detyrimisht identitet krahinor.¹² Në fillimvitet e '90, UÇK u rrit në formë më efektive në kufijtë me zonat më kufitare të Kosovës dhe

⁹James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 78.

¹⁰Arnend R. Bekaj, ‘The KLA and the Kosovo War: From Intra-State Conflict to Independent Country’, 12.Shih dhe James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 302. Anëtarët e Çetës së Llapit ishin kryesisht të burgosur politikë pas demonstratave të '81, të cilët ideologjikisht rrjedhnin nga “Fronti i Kuq i Kosovës”. Numri më i madh i tyre iu bashkuan LPRK gjatë viteve në vijim të '80. Shih po aty, 100.

¹¹*Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 84.

¹²*Po aty*, 303.

rrjedhimisht duke e zgjeruar aktivitetin e saj.¹³Në vitin 1993 në Drenas u vranë dy policë serbë dhe 5 të tjerë u plagosën, ndërkaq në vitin 1995 dy policë serbë u sulmuan me bombë dore dhe me automatikë, gjë që shkaktoi plagosjen e rëndë të tyre. Sipas disa të dhënave serbe, gjatë viteve 1992-1995, kishte pasur rreth 136 sulme guerile kundër policisë serbe në Kosovë.¹⁴

Përkundër që guerilët zakonisht vendosin në shënjestër rrugët kryesore në mënyrë që të pamundësojnë lëvizjen dhe furnizimin e armikut, sulmet guerile të pjesës së parë të viteve të '90 zakonisht vënë në shënjestër stacionet policore apo sulmet e izoluar në grupe të policëve serbë. Një taktikë e tillë edhe pse i përket luftës së gjeneratës së katërt, ku kryengritësit synojnë tëdelegjitimojnë pushtetin përmes sulmeve guerile, specifikisht kjo formë e taktikës së përdorur nga UÇK-ja mund të konsiderohet si taktikë maoiste dhe gevariste dhe jo sovjetike, në kuptimin që guerilët kërkonin krijim të përshtypjes që armiku po humbte kontrollin mbi territor, por që realisht nuk kishte mundësi ushtarake të përvetësonte kontrollin territorial atëbotë.¹⁵

Kjo strategji është e dukshme që nga vitit 1996, gjatë së cilës kohë sulmet po zhvilloheshin në numër më të shpeshtë në tërë Kosovën. Këto sulme ishin tipike guerile ngaqë e shfrytëzonin njohurinë e terrenit vendor duke i vënë në pritë kundërshtarët, por dhe

¹³Po aty, 95.

¹⁴Sadik Krasniqi, *Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)* (Prishtinë, 2009), 33.

¹⁵James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga Një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 93-94. Pettifer e shtron për para argumentin që ndikim në zhvillim e një qasjeje maoiste kishte pasur edhe fakti që Kudusi Lama dhe oficerë të tjerë të brezit të tij ishin arsimuar në Akademinë Ushtarake në Tiranë gjatë periudhës kur Shqipëria mbante marrëdhënie miqësore me Kinën, dhe në këtë formë ishin edukuar me tekste maoiste. Shih po aty, 334-335.

sulmet që i ndërmerrnin në pozicionet strategjike të serbëve (si ato të bazave ushtarake në Lluzhan, Kerpimeh, Besianë, Prishtinë, Deçan e gjetkë), tregojnë tipare të strategjisë guerile të luftës,¹⁶ndërkaq edhe prioriteti i ushtarëve ishte që të ndërtonin një arsenal me armë të lehta.¹⁷Si trajtë e luftës politike që po ushtronin UÇK-ja, mund të merret edhe fakti që pjesë e strategjisë së tyre ishte vënia në shënjestër e policëve, përkundër sulmeve në rrugë kryesore si hekurudhat, ngaqë e konsideronin që efekti politik i së parës do të ishte më i madh kundër Beogradit, përkundër që do të ishte më e logjikshme të dëmtoheshin linjat e furnizimit të forcave serbe.¹⁸

Në prill të vitit 1996, policia serbe e sulmoi një student shqiptar i cili vdiq më vonë nga plagët. Një akt i tillë nxiti reagim nga UÇK-ja, të cilët me rastin e varrosjes së viktimës, sulmuan policinë serbe në rrethinën e Deçanit dhe Pejës, me të cilin rast u vranë 5 serbë, nga të cilët 3 ishin civilë dhe 2 policë, ndërkaq 5 të tjerë u plagosën.¹⁹Gjatë periudhës qershor-tetor 1996 u kryen 15 aksione të armatosura, si pasojë e së cilave ishin vranë 15 policë serbë dhe 12 të tjerë të plagosur.²⁰

Karakteristikë për këtë periudhë është fakti që UÇK-ja kishte filluar të vejë në shënjestër figura me pozitë të rëndësishme politike ose shoqërore, siç është rasti me sulmin me bombë në makinë ndaj

¹⁶Hamdi V. Thaçi, *Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni 1 i Brigadës 114 'Fehmi Lladrovci'* (Prishtinë, 2017), 77.

¹⁷James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 107.

¹⁸*Po aty*, 112.

¹⁹Sadik Krasniqi, *Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)*, 34.

²⁰Hamdi V. Thaçi, *Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni 1 i Brigadës 114 'Fehmi Lladrovci'*, 77.

rektorit të atëhershëm të Universitetit paralelserb të Prishtinës, Radovan Papoviçit, në janar të 1997.²¹Nga kjo periudhë, karakteristikë tjetër e luftës guerile është organizimi në nivel lokal, kucelulat e UÇK-së po themeloheshin në fshatra, duke përdorur si baza shtëpitë familjare të personave të përfshirë në UÇK. Një vazhdë e sulmeve guerile të kryera nga UÇK-ja ngjau edhe përgjatë vitit 1997, ku u kryen rreth 13 aksione kundër policisë serbe, të cilat tashmë u kryen në formë më të organizuar dhe të urdhëruara drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.²²Në këtë periudhë, rrjeti organizativ i UÇK-së shtrihej në të gjitha krahinat si sistem i ndërlidhur që vepronin brenda një hierarkie të përbashkët ushtarake, e cila vepronte nën udhëheqjen e Adem Jasharit, si komandant i përgjithshëm i UÇK-së.²³Kësaj periudhe i përkasin edhe ngjarjet e shtrirjes së UÇK-së edhe në qendra urbane, si pasojë e amalgamimit me grupet e tjera guerile që operonin nëpër qytete si LKÇK.²⁴

2. Çështje tipologjike të luftës

Tranzicioni prej luftës guerile në luftë frontale në pozitë të transformuar nga ofensivë nëdefensivë ngjau në nëntor të 1997. Ky tranzicion u karakterizua me disa ofensiva ndaj forcave serbe, ku mund

²¹Sadik Krasniqi, *Lufta për Çlirimin e Kosovës (1997-1999)*, 34.

²²Hamdi V. Thaçi, *Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni 1 i Brigadës 114 'Fehmi Lladrovci'*, 78.

²³*Po aty*, 81.

²⁴Arnend R. Bekaj, 'The KLA and the Kosovo War: From Intra-State Conflict to Independent Country', 18.Këtu vlen të përmendet njësia guerile "Rexhep Mala" që vepronte në Prishtinë dhe rrethinën e saj nën komandën e Sali Mustafës.

të veçohet përdorimi i armëve kundërtank në afërsi të Deçanit.²⁵ Sulmi i parë nga radhët e policisë serbe i kryer ndaj fshatit Vojnik ku banonte dhe vepronte me luftëtarët e tij, Abedin Rexha, ishte një ofensivë që synonte shuarjen e veprimtarisë së kësaj celule të UÇK-së në fshatin Vojnik të komunës së Skenderajt, që ndodhet ndërmjet fshatit Izbicë dhe Burojë. Fshati ndodhet në një pozitë kodrinore e rrethuar me fshatra të banuara nga shqiptarë, gjë që lehtësonte dukshëm procesin e rekrutimit dhe shtrirjen e kontrollit për UÇK-në. Nisur nga supozimi se policia serbe kishte informata që këtu vepronin UÇK-ja, policia serbe kishte sulmuar shtëpinë e Abedin Rexhës, më 25 nëntor të atij viti. Sulmit iu kundërpërgjigjën Abedin Rexha së bashku me familjen, dhe arritën t'i zbrapsin forcat serbe. Si shenjë hakmarrjeje, të nesërmen, më 26 nëntor, një vargon me forca të shtuara serbe (përfshirë këtu tanke, pizgauer dhe helikopterë), u nisën nga Mitrovica përmes Skenderajt në Vojnik, me të cilin rast trupat e UÇK-së nën urdhrat e Adem Jasharit, i bënë pritë në disa pika kyçe në rrethinën e Skenderaj, në Rrezallë të Re, dhe i mposhtën forcat serbe.²⁶

Sulmi i parë ndaj shtëpisë së Abedin Rexhës në Vojnik dhe koha kur ndodhi ai, mund të interpretohet si pjesë e strategjisë antiterroriste nga ana e forcave serbe për të zvogëluar kontrollin e UÇK-së mbi territore të caktuara, dhe në këtë formë të izolojë këto zona që të

²⁵James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 128.

²⁶Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (Prishtinë, 2006), 41. Hamdi V. Thaçi, *Drenica djepi i UÇK-së dhe Batalioni 1 i Brigadës 114 'Fehmi Lladrovci'*, 84-85.

ndërprejë mundësitë e rekrutimit dhe furnizimit me armë dhe municion.²⁷

Ndërkaq, UÇK-ja filloi të marrë pozicione më afatgjate që nga viti 1998, ku dhe formuan zona të vogla me kontroll të përhapur, kështu rrjedhimisht duke bllokuar rrugët ndërlidhëse ndërmjet fshatrave, dhe në të cilën mënyrë e pamundësuan depërtimin e forcave serbe, dhe i bënë kushtet më të favorshme për rekrutë të rinj dhe njëkohësisht përhapjen e kontrollit të UÇK-së në pjesën më të mirë të krahinave rurale. Një forcim i tillë mundësoi që më 28 shkurt të vitit 1998, në betejën e Likoshanit, forcat e UÇK-së nën udhëheqjen e Adem Jasharit, t'i shkaktojnë disfatë forcave serbe.²⁸ Ngjashëm ndodh edhe me rastin e betejës në fshatin Abri, ku që nga 4 marsi 1998, UÇK kishte marrë haptazi pozicionet e tyre te vendi i quajtur “Arat e Hajdarit”, dhe në këtë formë kishin mbyllur rrugën Baicë-Abri dhe kishin pamundësuar depërtimin e forcave serbe.²⁹ Në këtë periudhë e shohim edhe paraqitjen e parë të celulave të organizuara më mirë, siç ishte rasti i “Njësitit Guri”, i cili përhapte kontrollin e saj në pjesën më të mirë të Drenicës së epërme (përfshirë fshatrat Abri, Tërdevc, Gullubovc, Baicë, Tërstenik, Çikatovë e Re, Shtrubullovc etj.).³⁰ Ndikim të madh në rritje të hovshme të numrit të rekrutëve të UÇK-së pati edhe rënia e familjes Jashari në Prekaz, ku u shua pothuajse e tërë familja Jashari në luftë kundër forcave serbe, gjë që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikoi në vetëdijesimin e popullatës shqiptare për nevojën e luftës së

²⁷James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 79.

²⁸Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, 24.

²⁹Selman Krasniqi, *Drenica e epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (Prishtinë, 2015), 84.

³⁰*Po aty*, 83.

armatosur.³¹Një karakteristikë tjetër e luftës së vonë guerile të UÇK-së, mund të vërehet edhe në mars të 1998 ku duhet theksuar që kishte grupe të vogla të armatosura që po lëviznin dhe vepronin pa ndonjë udhëheqësi ushtarake, madje ata gërmonin edhe llogore për t'i përdorur si mbrojtje kundër autoblandave të rënda serbe. Taktika të tilla të përdorimit të njohurisë për terrenin vendor të përdoret në avantazh të guerilëve ishin përdorur edhe në Luftën e Koresë, por e kishin përvetësuar edhe Vietkongu me tunelet e tyre tejet komplekse.³² Këto grupe iu bashkëngjitën rendit hierarkik të UÇK-së në vitin 1999 nën Zonën Operative të Drenicës.³³

Në formë më tradicionale e shohim shfaqjen e luftës balllore në maj të 1998 në Llapushnik, në qershor në Carralevë, të cilat si pasojë e rëndësisë strategjike u bënë vend i luftimeve të herëpashershme.³⁴

Në muajt në vijim të 1998, veçmë ngjan ristrukturimi i UÇK-së, me të cilin rast nënzonat operative shndërrohen në zona operative nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u vendos në Likoc.³⁵ Ndërkaq, në maj të 1998, UÇK-ja kishte kontroll mbi pjesë të mira të Gjakovës dhe Deçanit, nga ku kishin shtrirë kontrollin mbi pjesën e Rahovecit, Suharekës dhe Istogut dhe tutje në Kaçanik, Lipjan dhe Ferizaj. Supozohet se në këtë pikë, UÇK-ja

³¹Garentina Kraja, *Recruitment Practices of Europe's Last Guerrilla: Ethnic Mobilization, Violence and Networks in the Recruitment Strategy of the Kosovo Liberation Army*, (Yale University, 2011), 22.

³²James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 147-148.

³³Sadik Krasniqi, *Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)*, 31.

³⁴ ICTY, IT-03-66-T, Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, 23 (ICTY 2005).

³⁵Selman Krasniqi, *Drenica e epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, 37.

kontrollonte rreth 30% të territorit të Kosovës.³⁶Më vonë, në qershor të 1998, UÇK-ja kontrollonte rreth 35% të territorit, dhe mund të operonte në rreth 65% të saj.³⁷

UÇK-ja praktikonte formë të luftës guerile që njihet si gjenerata e katërt e llojit të luftimit që ishte konceptuar nga Mao Ce Duni, ku qëllimi nuk ishte të fitonin vetëm duke i mundur forcat e kundërshtarit. Në këtë kuptim, lufta përdorej si pjesë e një strategjie më të gjerë politike për të bindur kundërshtarin të largohet nga terreni, dhe mbi të gjitha ta bindë opinionin ndërkombëtar për të intervenuar në anën e kryengritësve.³⁸

Këto taktika ishin përdorur edhe nga Vietkongu, por edhe nga sandinistët në Nikaragua, ku të parët tentonin të thyenin motivimin e kundërshtarëve, ndërkaq, të dytët luftonin që të shkatërronin mbështetjen ndërkombëtare të regjimit të Somozas. Paralele ngjashmërie mund të tërhiqen edhe me ELAS (Ellinikos Laïkos Apeleftherotikos Stratos - Ushtria Çlirimtare Popullore e Greqisë) dhe EAM (Ethniko Apeleftherotiko Metopo – Frontit Nacionalçlirimtar) në Greqi, gjatë Luftës së Dytë Botërore, si në kontekst të platformave ideologjike të LPK-së dhe LKÇK-së, kur shohim edhe shfaqjen dramatike të UÇK-së, më 1997, e cila mund të krahasohet me shfaqjen dramatike të ELAS dhe efektin që kishte kjo te kundërshtari po edhe te rritja e numrit të rekrutëve për partizanët grekë.³⁹

³⁶ ICTY, IT-03-66-T, Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, 55 (ICTY 2005).

³⁷ ICTY, IT-03-66-T, po aty, 58.

³⁸Henry H. Perritt, *Kosovo Liberation Army: The inside Story of an Insurgency* (Urbana, 2008), 67.

³⁹James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, 135.

Në anën tjetër, ka ngjashmëri të madhe ndërmjet luftës guerile të UÇK-së dhe revoltës së Mau Maut në Kenja (1952-1964), si dhe luftës së Frontit Popullor të Zi (1964-1979) në Zimbabve për sa i përket shtytjes ideologjike kombëtare dhe përdorimin e njohjes së terrenit si avantazh të vetëm në luftë.

Nga aspekti taktik, UÇK ngjasonte më shumë me sandinistët sesa Vietkongun. Këta të parët e përdorin luftën e armatosur si strategji për të nxitur mbështetjen e opinionit ndërkombëtar.

Një dallim tjetër thelbësor që ekzistonte në mes të ushtarëve të UÇK-së dhe luftëtarëve të Vietkongut, qëndronte në mënyrat e rekrutimit, ku të parët shfrytëzonin lidhjet miqësore dhe familjare për të përhapur thirrje për t'iu bashkuar luftës për çlirim, përderisa luftëtarët e Vietkongut rekrutoheshin jo vetëm përmes idealizmit po edhe presionit politik apo ushtarak. Një praktikë e tillë u paraqit edhe në luftën guerile në Kenia dhe Zimbabve, ndërkaq në luftërat guerile në Amerikën Jugore gjatë Luftës së Ftohtë, rekrutimi ushtrohej përmes përhapjes së propagandës ideologjike. Përparësitë e armatimit më të mirë dhe më të madh në numër, ishin gjithashtu të dallueshme te ushtarët e Vietkongut,⁴⁰ të cilët kishin në posedim edhe zollë, një gjë që ishte evidente edhe në Zimbabve, gjë që ushtarët e UÇK-së filluan ta kenë vetëm nga fundi i luftës.

Me rritjen e numrit e ushtarëve të UÇK-së, ndërruan edhe taktikat e tyre guerile, duke u marrë pozita më afatgjate të konfrontimit konvencional. Një efekt tjetër për masivizimin e luftës ishte edhe masakra e Jasharajve, ngjarje kjo që shumëfishoi pjesëmarrjen e vullnetarëve në UÇK. Gjatë verës së 1998 UÇK përdori taktika

⁴⁰Gregor Schöllgen, *Krieg: Hundert Jahre Weltgeschichte*, 1. Auflage (München, 2017), 171.

konvencionale për të marrë kontroll mbi rrugën Pejë-Gjakovë, pjesë të rrugës Prishtinë-Pejë dhe Mitrovicë-Pejë, duke ia lënë të hapur policisë dhe ushtrisë serbe vetëm rrugën Prishtinë-Prizren. Ata kishin nën kontroll qytete prej Drenicës në Dukagjin, dhe madje për një periudhë të shkurtër kishin nën kontroll edhe Ferizajn.

Struktura ushtarake e UÇK-së u konsolidua plotësisht në verën e '98, gjatë fundit të korrikut dhe gushtit të atij viti. Zona Operative e Drenicës përfshinte brigadat 111, 112, 113, 114.⁴¹ Ajo e Pashtrikut përfshinte brigadat 121-127, Zona Operative Dukagjinit brigadat nga 131 deri 138, Zona Operative e Shalës 141 dhe 142, Zona Operative e Llapit përfshinte brigadat 151 deri 153, Zona Operative e Nerodimes përfshinte brigadat 161-162, dhe e Zona Operative e Karadakut kishte brigadat 171 dhe 172.⁴² Brigadat përbëheshin nga batalionet, dhe batalionet nga grupe të cilat përbëheshin nga togat.⁴³

Gjatë kësaj periudhe mund të konsiderojmë që UÇK-ja përbënte një ushtri të mirëfilltë. Zhvillimi i luftës frontale pas verës së 1998 si pasojë e krijimit të zonave të lira nga UÇK-ja të cilët synonin mbrojtjen e civilëve dhe rritjen e besueshmërisë së saj te popullata shqiptare dhe te fuqitë perëndimore, e vënë atë në një pozicion që i lejoi forcave serbe të përdorin epërsinë e tyre ushtarake më me lehtësi. Strategjia e zonës së lirë bëri betejën më simetrike, ndërsa sasia e forcave dhe fuqia e UÇK-së ishin akoma asimetrike sa ato që kishin qenë që nga fillimi, meqë Millosheviqi tani kishte prezantuar më shumë njësi ushtarake me përvojë me forcë të fortë dhe forca të blinduara më të rënda. Tani, me

⁴¹ ICTY, IT-03-66-T, Prosecutor v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, 24 (ICTY 2005).

⁴² ICTY, IT-03-66-T, po aty, 25.

⁴³ Sadik Krasniqi, *Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)*, 103-105.

anë të ushtrisë dhe jo të policisë, UÇK-ja pësoi humbje të theksuara. Ramush Haradinaj kishte jo më shumë se gjashtëdhjetë ushtarë në tërësi në rajonin e Dukagjinit. Remi (Rustem Mustafa) u tha se kishte më së shumti ushtarë nën komandën e tij në Zonën Llap se çdo komandant i zonës diku tjetër në Kosovë, dhe kjo ishte ende më pak se njëqind. Drenica ishte nën një gjendje të rrethimit dhe ushtarëte UÇK-së dhe komandantët ishin të preokupuar me ndihmën që familjet e tyre të mbijetonin në vend që të organizojë vepra efektive kundër serbëve.⁴⁴

Mirëpo, armëpushimi i tetorit të 1998 i dha mundësinë UÇK-së që të rikuperohej, dhe luftimi rinisi në tetor të 1998. Në këtë periudhë, gjatë shtatorit dhe dhjetorit të 1998, u zhvilluan beteja në zonën e Llapit, në afërsi të malit Kaçandoll, ku UÇK-ja doli fitimtare. Zhvillimet e fazave vijuese të luftës, obliguan UÇK-në të zhvendoset në luftë ballore në të gjitha frontet, si formë e parandalimit të spastrimit etnik të ushtruar nga ushtarët dhe policët serbë.⁴⁵

Ndërkaq nga tetori i vitit 1998, forcat serbe kishin nisur një strategji të spastrimit etnik, ku deri në atë pikë i kishin vrarë rreth 2 mijë civilë, e 200 mijë të tjerë ishin zhvendosur, dhe kishin shkatërruar mbi 7 mijë ndërtesa, e kishin djegur në mënyrë të qëllimshme rreth 269 fshatra.⁴⁶ Kjo formë sistematike e dhunës ndaj civilëve vetëm sa u intensifikua gjatë vitit 1999.

Përkundër të gjitha sfidave me të cilat u përball UÇK-ja, si luftë guerile ajo e shënon një nga luftërat më të suksesshme të periudhës së pas Luftës së Ftohtë, e cila duke shfrytëzuar burimet e reduktuara

⁴⁴Henry H. Perritt, *Kosovo Liberation Army*, 56-57.

⁴⁵*Po aty*, 77.

⁴⁶Garentina Kraja, 'Recruitment Practices of Europe's Last Guerrilla: Ethnic Mobilization, Violence and Networks in the Recruitment Strategy of the Kosovo Liberation Army', 47.

njerëzore, financiare dhe ushtarake, arriti të fitojë luftën dhe ndalojë spastrimin etnik duke marrë vëmendjen dhe përkrahjen e komunitetit ndërkombëtar.⁴⁷

⁴⁷Henry H. Perritt, *Kosovo Liberation Army*, 2.